

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “ KOI ” SH.P.K

Ne Tiranë, sot me date 08/03/2023 , ne të nënshkruarit më poshtë:

- **Z.** Gerhard SULAJ, i biri i Ilirit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 10 / 01 / 1981, lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqipërisë me numer personal: I10110061U.

- **Z.** Enea SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas shqiptar, i datelindjes 07.08.1981, lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqipërisë me numer personal: I10807056N.

Ne baze e per zbatim te ligjit nr 9901 date 14.04.2008”Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “i ndryshuar dhe legjislacionit te Republikës se Shqipërisë ne pergjithesi, vendosem si vijon:

Kreu I

Emertimi, Selia,objekti,afati i shoqerise

Neni 1

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga akti i themelimit,statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet ” **KOI**”sh.p.k.

Neni 3

Selia Qendore e Shoqërisë është në adresen: Rruga Marko Bocari pall 82 , Tirane .

Shoqëria mund te hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera,brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra ne vende të ndryshme, perveç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

Neni 4

Objekti i shoqërisë do të konsistoje ne :

- Veprimtari ndertim objektesh , ndertim veprash rrugore, industriale, turistike, etj. Tregtim, import-export te materialeve ne fushen e ndertimit. Import export produktesh bujqesore, ushqimore, apo te cfaredo lloj industrie tjeter. Aktivitete ne fushen e turizmit, agriturizmit. Ndertim dhe Prodhim Energjie nga centrale eolike, solare, hidrike, gjeotermale, apo forma te tjera prodhimi energjie. Veprimtari ne fushen e sporteve te ndryshme dhe aktiviteteve te tjera argetuese. Veprimtari ne fushen e mjekesise dhe farmaceutikes, permes klinikave, spitaleve apo formave te tjera te trajtimit mjekesor. Veprimtari ne fushen e ristoracionit, bareve, restoranteve, hoteleve. Veprimtari ne fushen e prodhimit dhe perpunimit te produkteve te ndryshme ushqimore apo cfaredo lloj forme tjeter industrie. Veprimtari ne fushen imobiliare, permes hapjes dhe menaxhimit te zyrave imobiliare. Veprimtari ne fushen e finacimit te fushave te ndryshme te ekonomise permes celjes dhe menaxhimit te fondeve te investimit.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqërise është për një periudhë të pacaktuar kohe

Kreu II

Kapitali , ortaku , veprimtaria .

Neni 6

Kapitali

6.1.Kapitali themeltar I shoqërise është **10.000 leke(dhjetmije)** që perben **2 kuota**, sipas pjesëmarrjes së themeluesve në kapitalin e shoqërise në përputhje me kontributet si më poshtë:

Ortaku Gerhard SULAJ, i biri i Ilirit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 10 / 01 / 1981, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit të Republikës së Shqipërisë me numër personal: I10110061U; zotëron 1 (një) kuota, me vlerë 5000 (pesë mijë) lekë, e barabartë me 50 % (pesëdhjetë përqind) të vlerës së kapitalit.

Ortaku Enea SHERIFI, i biri i Elmazit, shtetas Shqiptar, i datelindjes 07 / 08 / 1981, lindur në Tepelene dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit të Republikës së Shqipërisë me numër personal: I10807056N ; zotëron 1 (një) kuota, me vlerë 5000 (pesë mijë) lekë, e barabartë me 50 % (pesëdhjetë përqind) të vlerës së kapitalit.

6.2.Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe Statut. Kuotat e kapitalit shoqërise e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

6.3.Ortaku mban përgjegjësi të kufizuar në marrëdhëniet juridike –civile me të tretet,përgjegjësi që kufizohet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar prej tij.

Neni 7

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërise.

Neni 8

Veprimtaria e shoqërise mund të ushtrohet duke krijuar filiale dhe perfaqësi Brenda dhe jashtë vendit ,konform ligjit shqiptar.

Kreu III

Organet e shoqërise .

Neni 9

9.1.Shoqëria është e organizuar në organet e saj drejtuese të cilat janë:

1-Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

2-Administratori

9.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht, në perputhje me ligjin dhe me Statutin vendime te cilat janë të detyrueshme per të gjithë ortakët perfshirë ata që mungojnë.

9.3. Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, jane si me poshte:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10

10.1. Organi vendimmarres I shoqerise „Asambleja e Ortakeve emerone me shumice te thjeshte nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.

10.2. Afati I emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripërteritje. Emerimi I administratorit prodhon efekte vetem pas Regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

10.3. Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në cdo kohë, me vendim te marre me shumice te thjeshte nga Asambleja.

10.4. **Administrator I shoqerise emerohet z.** Shoqëria do të drejtohet nga Z.Gerhard SULAJ, i biri i Ilirit, shtetas Shqiptar, lindur me 10 / 01 / 1981 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit te Republikës se Shqiperise me numër personal: I10110061U.

Emerohet per nje afat 5 vjecar me te drejte ripërteritje. Administratori mund te shkarkohet me shumice te thjeshte nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

Kreu IV

Likujdimi , riorganizimi , baza ligjore .

Neni 11

Prishja dhe Likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.;

c)ne rast se objekti behet I perealizueshem per shkak te mosfeksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe qe bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregatre

d)ne rastet e pavlefshmerise se themelimit

e)ne raste te tjera te parashikuara ne ligj

f)per cdo shkak tjetet te vendosur nga Asambleja e Ortakeve

Neni 12

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

12.1.Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", I ndyshuar.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji lex specialis në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarreveshjeve


Për zgjidhjen e mosmarreveshjeve që kanë të bëjnë me interpretimin e këtij akti themelimi apo ato që mund të lindin midis ortakëve apo ortakëve dhe të tregtarëve, kompetente për këto do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtit ligjor.


Akti I themelimit pasi u lexua dhe u kuptua nga palet nënshkruhet prej tyre me vullnet të lire, të plote e të pavesuar.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z. Gerhard SULAJ



Z. Enea SHERIFI



Akt Themelimi I shoqerise " KOI " SHPK